Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr 06-31917 */26*
Klinë, dt: 06.10 */26*

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17.08.2026, me fillim në orën 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Enver Berisha, i cili përshëndeti nënkryetarin e komunës, z. Fadil Gashi, si dhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Informatë për Qarkoren e Dytë Buxhetore dhe konsultimi lidhur me orarin e konsultimeve buxhetore (ref.drejt.Fin);
4. Shqyrtimi i kërkesave të pranuara në Komitetin për Politikë dhe Financa gjatë periudhës qershor-korrik 2026;
5. Të ndryshme.

Enver Berisha, kryesues: Ju përshëndes të gjithëve. Kjo është mbledhja e gjashtë që po e mbajmë si Komitet për Politikë dhe Financa. Besoj se rendin e ditës e keni marrë me kohë. Nëse dikush ka diçka për të shtuar rreth rendit të ditës, që vlerëson se mund ta fusim në këtë mbledhje apo ta planifikojmë për seancën e radhës, e hap debatin. Nëse jo, atëherë, kush është për miratimin e rendit të ditës?

e Kuvendit Komunal. Asamblistët janë të mirëseardhur që të japin kontributin e tyre.
Po e hap debatin. Urdhëro, z. Valmir Bacaj.

Valmir Bacaj: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë.
Orari i debateve dhe dëgjimeve buxhetore tashmë është bërë publik. E kam parë edhe në uebfaqen e Komunës, edhe në rrjetet sociale. Kështu që, kontributin tonë do ta japim edhe në dëgjimet buxhetore, edhe në Asamble, lidhur me projektet dhe buxhetin e vitit 2027.
Faleminderit shumë.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, z. Bacaj. Dikush tjetër? Urdhëro, z. Esat Raci.

Esat Raci: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë.

E arsyetuat çështjen, megjithëse edhe unë po e arsyetoj, meqë është muaji i pushimeve. Do të ishte dashur që dikush nga Ekzekutivi të ishte i pranishëm dhe të na njoftonte pak më gjerësisht lidhur me këtë çështje. Le të mbetet kjo për vazhdimin e diskutimeve rreth qarkoreve buxhetore dhe shpresoj që Ekzekutivi të japë kontributin e vet. Shpresoj dhe apeloj që të mos jetë buxhet politik për vitin 2027. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, z. Esat Raci. Pikërisht në këtë që e thatë ju, z. Raci, unë do të kërkoja që Asambleja Komunale të jetë aktive, që anëtarët e Kuvendit të jenë aktivë, t'i japin idetë dhe propozimet e tyre dhe të dalë një projektbuxhet i vlerësuar jo vetëm prej qytetarëve dhe Ekzekutivit, por edhe prej përfaqësuesve të popullit këtu, të cilët e kanë marrë votën në emër të këtij angazhimi. Në një mënyrë, ne duhet ta bëjmë përfaqësimin e qytetarëve edhe përmes projekteve konkrete në këtë projektbuxhet. Për dëgjimet buxhetore, përsëri po ju bëj ftesë dhe po them që, mundësisht, në zonat ku gravitoni të jeni aktivë dhe të jepni kontributin tuaj për projektbuxhetin e vitit 2027. Kush është për?

Me 7 vota PËR u pajtuan për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, deri ne aprovimin e buxhetit për vitin 2027.

Pika 4 – Shqyrtimi i kërkesave të pranuara në Komitetin për Politikë dhe Financa gjatë periudhës qershor–korrik 2026.

Kërkesë e parashtruar nga znj. Sanije Deskaj, e cila thekson:

Z. Shefqet Deskaj, në vitin 2019, ka pësuar gjakderdhje në tru dhe, që nga ajo kohë, është në gjendje të paralizuar. Deri më tani, të gjitha shpenzimet mjekësore i kemi përballuar me ndihmën e familjarëve tanë, ndërsa që nga viti 2022 nuk kemi më mundësi t'i përballojmë këto shpenzime, pasi ato janë shumë të larta. Gjithashtu, për shkak të krizës që ka kapluar vendin, shpenzimet janë rritur edhe më tej.

Në pamundësi për t'i përballuar shpenzimet dhe obligimet mjekësore, kërkojmë nga Komuna e Klinës që të na mbështesë me ndihmë financiare, në masën që mundësitë e Komunës e lejojnë.

Kërkesën, për shkak të pamundësisë së bashkëshortit për ta parashtruar personalisht, e bëj në emër të tij, ndërsa mbështetja financiare kërkohet të jetë në emër të z. Shefqet Deskaj, pasi jam e autorizuar në llogarinë e tij bankare.

Enver Berisha, kryesues: Ndoshta një pjesë e juaja mund të jetë në ngjarje, që ky vuan nga një sëmundje prej disa vitesh, ka pasur sulm në tru dhe, sigurisht, bazuar në nevojat shëndetësore që ka, na është drejtuar edhe për mjete financiare. Unë jam që kjo kërkesë t'i drejtohet Kryetarit të Komunës, ashtu siç është kompetencë e tij, për t'i trajtuar këto kërkesa. Besoj se nga ana e anëtarëve të Komitetit ka mirëkuptim në këtë drejtim. Sidoqoftë, e hap debatin për këtë kërkesë. Nëse dikush ka diçka për të shtuar apo për të thënë më shumë, urdhëroni. Urdhëro, z. Esat Raci.

Esat Raci: Faleminderit, kryesues. Unë personalisht e mbështes fuqishëm kërkesën e familjes së z. Shefqet Deskaj për ndihmë financiare. Të gjithë ne që jemi të pranishëm këtu e dimë situatën e rëndë shëndetësore të Shefqetit, si dhe gjendjen e familjes së tij. Pas sulmit që ka pasur Shefqeti, familja është përballur me shpenzime të vazhdueshme për terapi dhe trajtim, si dhe me vështirësi të mëdha financiare. Pikërisht për shkak të kësaj gjendjeje financiare, familja është detyruar të kërkojë ndihmë. Nuk e lë fajtor familjen për këtë situatë, por përgjegjësinë e shoh edhe te institucionet shtetërore. Sikur shëndetësia të ishte në nivelin e duhur, me siguri familja do ta kishte më të lehtë përballimin financiar të kësaj gjendjeje. Prandaj, brenda mundësive buxhetore të institucioneve, në këtë rast të Kryetarit të Komunës, duhet të shqyrtohet mundësia që familjes t'i ndihmohet. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, z. Raci. Dikush tjetër? Urdhëro, z. Arben Limanaj.

Arben Limanaj: Përshëndetje për të gjithë. Edhe unë e mbështes kërkesën për ndihmë financiare për z. Shefqet Deskaj dhe e konsideroj të arsyeshme, duke e pasur parasysh gjendjen në të cilën ndodhet. Sa kam informacion, familja ka shitur edhe pronë për t'ia mundësuar trajtimin dhe përballimin e kësaj gjendjeje. Nëse ka hapësirë dhe mundësi Komuna, qoftë edhe për një ndihmë simbolike, mendoj se duhet të shqyrtohet mundësia për t'i ndihmuar. Familjen besoj se e njohim të gjithë. Ata nuk do t'i ishin drejtuar Komunës për ndihmë po të mos ishin në një gjendje të vështirë financiare. Sa kam informacion, edhe marketin e kanë shitur për shkak të gjendjes financiare dhe shpenzimeve që kanë pasur. Prandaj, qëndroj brenda asaj që, nëse ka hapësirë dhe mundësi, të gjendet një mënyrë për t'i ndihmuar, qoftë edhe në mënyrë simbolike, sepse e dimë që Komuna nuk mund të japë shuma të mëdha për raste të tilla. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, z. Limanaj. Urdhëro, znj. Teuta Mulaj.

Teuta Mulaj: Përshëndetje për të gjithë. Është mirë që t'i ndihmohet z. Shefqet Deskaj, duke e marrë parasysh gjendjen e tij shëndetësore dhe gjendjen financiare të familjes. Në kërkesë ceket një shumë, sado që të jetë ajo, edhe nëse është simbolike. Mendoj se një ndihmë për familjen do të ishte e mirëseardhur.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, znj. Mulaj. Urdhëro, z. Valmir Bacaj.

Valmir Bacaj: Faleminderit, kryesues. E di që z. Shefqet Deskaj vuan nga një sëmundje e rëndë dhe, siç e kam parë në raportet e paraqitura, kjo gjendje shëndetësore vazhdon prej vitit 2019. Shpenzimet e vazhdueshme për trajtim janë barrë e rëndë edhe për familjen. Prandaj, brenda mundësive, propozoj që t'i drejtohemi zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të kërkojmë që t'i dilet në ndihmë z. Shefqet Deskaj. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, z. Bacaj. Dikush tjetër?
Nëse jo, atëherë, bazuar në kërkesën dhe në diskutimet e anëtarëve, unë besoj se këtë kërkesë duhet t'ia drejtojmë Kryetarit të Komunës, me kërkesën tonë që të arsyetohet dhe të shqyrtohet mundësia e ndihmës për personin në fjalë, me shumën që Kryetari i Komunës e ka në dispozicion dhe që lejohet sipas kompetencave dhe mundësive buxhetore. Po ashtu, familja ka të drejta edhe në institucionet e tjera shtetërore. Në radhë të parë, nëse plotësohen kushtet, personi mund të ketë të drejtë për pension invalidor dhe familja mund të kërkojë mbështetje edhe përmes Qendrës për Punë Sociale. Megjithatë, ne po e mbrojmë kërkesën tonë dhe po kërkojmë që kjo familje të ndihmohet brenda mundësive dhe kompetencave të Komunës. A pajtoheni kështu? Kush është për?

Me 7 vota PËR u rekomandua që kërkesa e parashtruar për mbështetje financiare për z. Shefqet Deskaj të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit të Komunës së Klinës.

Pika 5 – Të ndryshme.

Enver Berisha, kryesues: Nuk e di nëse në këtë pikë të rendit të ditës ka dikush diçka për të shtuar. Me siguri do ta kemi në fillim të shtatorit edhe mbledhjen tjetër të Komitetit, para seancës së radhës të Kuvendit. Besoj se deri atëherë do të trajtohen edhe kërkesat e tjera. Sot e pamë se kanë arritur edhe disa kërkesa të tjera, të cilat nuk kanë qenë pjesë e rendit të ditës së kësaj mbledhjeje, por në mbledhjen e shtatorit do të jenë edhe ato për shqyrtim. Po ashtu, në atë periudhë do të jetë edhe projektbuxheti për vitin 2027. A ka dikush diçka për të shtuar në këtë pikë? Nëse jo, ju falënderoj për kohën që e keni ndarë për të qenë sot këtu në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Shihemi në takimin e radhës. Faleminderit për kontributin tuaj.

Procesmbajtësja
Monika Palushi Gojani

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIC OF KOSOVO · KOMUNA E KLINËS · MUNICIPALITY OF KLINA · OPŠTINA KLINA

KRYESUESI
z. Enver Berisha